

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektësh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Specialist Kontratash

❖ DETYRAT KRYESORE

- Përgjigjet për përgatitjen e formateve të standartizuara të kontratave të ndërtimit, sipermarrjes, shitblerjes, bashkëpunimit, qirase, punesimit, shërbimit, etj., dhe revizionimin e tyre.
- Ofron rishikim të plote dhe të shpejta të dokumentave të përgatitur nga pale të tjera.
- Kontrollon mirenajtjen e skedareve të detajuar dhe të organizuar për çdo kontratë nga Administratoret e Kontratave.
- Kontrollon, ndryshon, raporton tek strukturat përgjegjëse rregjistrin e përgjegjëseve kontraktuale midis paleve të ndryshme (Action/Notice/Liability Matrix) dhe kontrollon ekzekutimin e kontratave në përputhje me kushtet kontraktuale dhe politikën e kompanisë.
- Kontrollon përgatitjen e njoftimeve sipas kërkesave kontraktuale; monitoron performancën e Nenkontraktoreve; raporton statusin dhe plotësimin e kushteve kontraktuale të Punedhënësve, Kompanisë dhe Nenkontraktoreve, ose Paleve të tjera të Treta.
- Rishikon dhe finalizon korrespondencën e përgatitur nga struktura të ndryshme të kompanisë dhe/ose Administratoret e Kontratave në lidhje me zbatimin e kontratave.
- Kontrollon mbylljet e çdo Kontrate në fund të periudhës (close Out) dhe leshimin/marrjen e garancive të lidhura me kontratat.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Të ketë përfunduar fakultetin Juridik. Preferohet të ketë kualifikim në nivel pasuniversitar në fushën e juridikut ose financës.

Gjuhë të huaja: Anglisht (shkëlqyer), Italisht (shumë mirë).

Njohuri kompjuterike: Paketa Microsoft Office

Eksperienca e kërkuar: Min. 6 vite eksperiencë pune në përpilim kontratash. Preferohet të ketë eksperiencë pune në një kompani që operon në fushën e ndërtimit si dhe eksperiencë në kontrata FIDIC.

Te gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dergojnë CV nepermjet adreses së e-mailit careers@gener2.al ose të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.gener2.al në seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 10 Gusht 2022, ora 17:00**.

* Vetëm kandidatet e perzgjedhur do të kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrotjtjen e të dhënave personale”.